



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 344/2 prot

Datë 14.02.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT TË OPERATORIT EKONOMIK
ANKIMUES DHE PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN E OFERTUESVE TË TJERË

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Eurocar Rentals” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-85607-10-27-2023, me objekt: “Marrje automjete me qira”, me fond limit 96,992,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 22-01-2024 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Albpetrol.
- Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “Infinity Destinations ” SHPK & “Classic” SHPK, në procedurën e mësipërme e prokurimit.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Eurocar Rentals” SHPK me NIPT L71607505F dhe adresë Autostrada Tiranë-Durrës, km6, Durrës
- Autoriteti Kontraktor:** Sh.A Albpetrol me adresë Selia, Rruga Fier – Patos, km 7, Fier
- Subjekt i interesuar:** Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “Infinity Destinations” shpk me NIPT M11921027K dhe “C l a s s i c” shpk me NIPT J91909004J dhe adresë Rruga "Pjeter Bogdani" Pallati 9/1, Shkalla 1, Apartamenti 1, Tirane

Në datën 13.02.2024 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 344/2024 protokoll dhe me numër ankimi elektronik A/2024/3805 e operatorit ekonomik “EUROCAR Rentals” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-REF-85607-10-27-2023, me objekt “Marrje

automjete me qira” me fond limit: 96992000.0 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 22.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Albpetrol.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Eurocar Rentals” SHPK, si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “BOE “Infinity Destinations ” SHPK & “Classic” SHPK.

Bazuar në gërmat “b” dhe “c”, të pikës 4, të nenit 112 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “EUROCAR Rentals” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 344/2024 prot., datë 13.02.2024 dhe me numër ankimi elektronik A/2024/3805.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

- *Operatori ekonomik nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi per automjetet që ofron. Autorizimet e paraqitura ne rastin e distributorit te autorizuar nuk vertetojnë lidhjen e distributorit te autorizuar me firmen prodhuese, konkretisht:*

Për automjetet tip “KIA“;

Kompania “KMAG“ me seli në Podgoricë, deklaroi se është importues/distributor për automjetet KIA, sipas një marrëveshje të bërë me “KIA EUROPE“ dhe autorizon kompaninë “MEKTRIN MOTORS“ të importojë dhe shesë automjetet tip KIA. Më pas kompania “MEKTRIN MOTORS“ autorizon, në cilësinë e distributorit, ofertuesin “EUROCAR RENTALS” të shesë dhe riparojë automjetet KIA për këtë tender. Ndërkohë nuk është paraqitur dhe marrëveshja (dokumenti) midis “KMAG“ si distributor dhe “KIA EUROPE“ si prodhues, për të vërtetuar lidhjen midis distributorit dhe prodhuesit.

Për automjetin tip “EVO“;

Kompania “SYSTEM CARS“ SRL Itali si distributor, konfirmon se ofertuesi “EUROCAR RENTALS” është rishitës i autorizuar për makinat tip EVO CROSS 4, njëkohësisht autorizon “MEKTRIN MOTORS“ dhe “EUROCAR RENTALS” të marrin pjesë në këtë tender. Ndërkohë nga kompania prodhuese “EVO”, është paraqitur vetëm një propozim për kompaninë “SYSTEM CARS“ SRL Itali, që kjo kompani të jetë distributor për automjetet EVO, e pa finalizuar me një marrëveshje bashkëpunimi mes tyre apo autorizim prodhuesi. Si rrjedhojë lidhja midis kompanisë “SYSTEM CARS“ SRL Itali si distributor dhe “EVO” si prodhues, nuk provohet, pasi nuk është paraqitur nga ofertuesi një dokument që vërteton lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit të

autorizuar. Këto në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.3. të pikës 2.3 “Kapaciteti teknik”, të pikës 2. “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, të shtojcës 7 të DST-së.

• *Operatori ekonomik nuk plotëson specifikimet teknike të kërkuara nga AK në shtojcën 5 të DST-së, konkretisht:*

Për Automjetin tipi 3 SUV - Sasia 1 (nje), e re me zero kilometra

Kriteri Kërkesa e AK Oferta e OE (KIA SPORTAGE)

Fuqia motorike Min 100 kW. 85kW Kutia e shpejtësisë (Kambio) Automatike Manual

Disqe alumini min 18 17 inch përpara – 16 inch prapa.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimes “Eurocar Rentals” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga “BOE “Infinity Destinations” SHPK & “Classic” SHPK pjesmarrës në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushjen kritereve si më poshtë vijon:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.*

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqes autorizim prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për automjetet që ofron. Në rastin e distributorit të autorizuar të paraqitet edhe dokumenti që verteton lidhjen e distributorit të autorizuar me firmën prodhuese. Autorizimi duhet të përmbaje të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, ëbsite, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

2.3.1. Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se: 40 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

Si deshmi për pervojën e mëparshme kërkohen të paraqiten:

Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

OSE

Ne rastin e parës se meparshme te realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.2.2 *Kopje te certifikuar te bilancit për vitet financiare 2020, 2021, 2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të konfirmuar nga administrata tatimore*

2.3.2 *Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikaten ISO 9001:2015 ose e përditësuar mbi "Sistemin e menaxhimit të cilësisë", ose ekuivalente (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).*

2.3.5 *Operatori ekonomik të ketë servis të autorizuar për shërbimet që mund ti kryhen automatikisht.*

Per kete ofertuesi te paraqese:

- *Licence per autoriparimin e mjeteve rrugore leshuar nga QKB.*
- *Ne rastin kur nuk ka vete servis automatikisht te paraqese kontrate qiraje/bashkepunimi te lidhur para noterit me nje servis, qe te perfshije periudhen e kontratës objekt prokurimi për mjetet qe ofertoohen, shoqeruar me licencen per autoriparimin e mjeteve rrugore ne emer te servisit leshuar nga QKB.*

2.3.4 *Kataloge teknike/skede teknike, nga firma prodhuese per automatikisht që do të ofrohen. Katalogu/skeda teknike te permbaje karakteristikat teknike te automatikisht me qellim qe Autoriteti Kontraktor te gjykoje nese automatikisht plotesojne kerkesat teknike te percaktuara ne dokumentat e tenderit. Ne katalogun/et/skedat e paraqitur te shenohen ne menyre te dukshme lloji i automatikisht, se bashku me specifikimet teknike te kerkuara nga AK. (Pjeset specifike te katalogut/skedës teknike, ku jepen karakteristikat e mallit qe prokurohet nqs nuk jane ne gjuhen shqipe te perkthehen ne gjuhen shqipe dhe te noterizohen).*

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Kompania Albpetrol sh.a ka në administrim tre qendra prodhimi të naftës, QPN Kuçovë, QPN Fier dhe QPN Gorish dhe qendrën mbështetëse me flotën më të madhe QFT Patos të cilat aktivitetin e tyre e kanë në terren dhe rrugë të vështira (të gjithë kategoritë e rrugëve). Për këto arsye mjetet që u nevojiten duhen të jenë "Mjete tip fuoristrada" dhe me karroceri të lehtë ose ndryshe Pick Up për transport materiale, vegla pune dhe personeli inxhiniero-teknik .

Flota aktuale që kanë si qendrat e prodhimit dhe ato mbështetëse nuk arrijnë të mbulojnë punën voluminoze. Në programin e zhvillimit të shoqërisë Albpetrol sha të miratuar për vitin 2023 është parashikuar edhe marrja me qira operacionale (leasing) të 16 (gjashtëmbëdhjetë) automjeteve fuoristrada për një periudhë 4(katër) vjecare.

Specifikimet per automjetet:

Automjet tipi 1 Pick Up (Dopio Kabine) sasia 14 (katërmëdhjetë) copë të reja me zero kilometra

Specifikimet Teknike:

- Viti prodhimit/km Min viti 2022 / 0 km
- Cilindrata Min 2200 cc.
- Lenda djegese Naftë.
- Fuqia motorike Min 110 Kë.
- Numri i cilindrave Min 4
- Konsumi i kombinuar per 100 km Max 8 litra /100km.

Transmisioni:

- Kutia e shpejtesise(Kamio) Manuale.
- Terheqja 4x4.

Permasat e autovetures:

- Gjatesia Min 5 200 mm
- Lartesia nga toka Min 200 mm

- Gjeresia *Min 1 800 mm*
- Lartesia *Min 1 700 mm*
- Distanca aksiale *Min 3 000 mm*

Gabina:

- Numri i dyerve *4*
- Numri i vendeve *Min 4+1*

Aksesore shtese:

- Me timon hidraulik ne krahun e majte.
- Frenat me sistem ABS.
- Sistem ASR, ESP
- Airbeg per shoferin dhe pasagjerin.
- Xhamat me komandim elektrik.
- Ajer i kondicionuar /Clima.
- Sistemi elektrik 12V, si dhe te jete konform normave te CE.
- Mbyllje e centralizuar e dyerve, komandim ne distance.
- Radio
- Pedanat anesore
- Tempomat
- Disqe alumini min 16

Ngjyra e negocueshme ne lidhjen e kontrates

Afati i dorëzimit duhet të jetë brenda 60 ditëve nga lidhja e kontratës.

Automjet tipi 2 SUV - Sasia 1 (nje) e re me zero kilometra

Specifikimet Teknike:

- Viti prodhimit/km *Min viti 2022 / 0 km*
- Cilindrata *Min 2200 cc.*
- Lenda djegese *Naftë.*
- Fuqia motorike *Min 140 kë.*
- Numri i cilindrave *Min 4*
- Konsumi i kombinuar per 100km *Max 10 litra /100km.*

Transmisioni:

- Kutia e shpejtesise(Kambio) *Automatike*
- Terheqja *4x4.*

Permasat e autovetures:

- Gjatesia *Min 4800 mm*
- Lartesia nga toka *Min 200 mm*
- Gjeresia *Min 1900 mm*
- Lartesia *Min 1800 mm*
- Distanca aksiale *Min 2800 mm*

Gabina:

- Numri i dyerve *4*
- Numri i vendeve *Min 4+1*

Aksesore shtese:

- Me timon hidraulik ne krahun e majte.
- Frenat me sistem ABS, ESP, ASR, EDB
- Airbag min 6 cope.
- Xhamat me nuance.
- Xhamat me komandim elektrik.
- Ajer i kondicionuar /Clima.
- Sistemi elektrik 12V, si dhe te jete konform normave te CE.
- Mbyllje e centralizuar e dyerve, komandim ne distance.
- Pasqyrat dhe xhamat elektrike
- Disqe Alumini min 18"
- Led para dhe mbrapa
- Timon Multifunksional
- Bluetooth , cruise control
- Xhamat e erret mbrapa
- Rregjistrim lartesisie per timonin
- Funkcion start &stop
- Set riparim gome
- Sedilje lekure
- Kamera mbrapa

Afati i dorezimit duhet te jete brenda 60 diteve nga lidhja e kontrates

Automjet tipi 3 SUV - Sasia 1 (nje), e re me zero kilometra

Specifikimet Teknike:

- Viti prodhimit/km *Min viti 2022 / 0 km*
- Cilindrata *Min 1600 cc.*
- Lenda djegese *Naftë.*
- Fuqia motorike *Min 100 kë.*
- Numri i cilindrave *Min 4*
- Konsumi i kombinuar per 100km *Max 7 litra /100km.*

Transmisioni:

- Kutia e shpejtesise(Kamio) *Automatike*
- Terheqja *2x4.*

Permasat e autovetures:

- Gjatesia *Min 4400 mm*
- Lartesia nga toka *Min 180 mm*
- Gjeresia *Min 1800 mm*
- Lartesia *Min 1600 mm*
- Distanca aksiale *Min 2600 mm*

Gabina:

- Numri i dyerve *4*
- Numri i vendeve *Min 4+1*

Aksesore shtese:

- Me timon hidraulik ne krahun e majte.
- Frenat me sistem ABS, ESP, ASR,EDB
- Airbag min 6 cope.

- Xhamat me nuance.
- Xhamat me komandim elektrik.
- Ajer i kondicionuar /Clima.
- Sistemi elektrik 12V, si dhe te jete konform normave te CE.
- Mbyllje e centralizuar e dyerve, komandim ne distance.
- Pasqyrat dhe xhamat elektrike
- Disqe Alumini min 18
- Led para dhe mbrapa
- Timon Multifunksional
- Bluetooth , cruise control
- Xhamat e erret mbrapa
- Rregjistrim lartesis per timonin
- Funksion start &stop
- Set riparim gome

Afati i dorëzimit duhet të jetë brenda 60 diteve nga lidhja e kontrates.

- *Oferta ekonomike e OE, duhet të ketë të përfshirë:*
 - Të gjitha shpenzimet e nevojshme për importin e automjeteve dhe pagesës së detyrimeve doganore, sipas legjislacionit në fuqi.
 - Të gjithë shpenzimet e nevojshme për regjistrimin e automjeteve pranë institucioneve përkatëse, targimin e automjeteve dhe dokumentacionin e duhur ligjor si: certifikatë pronësie, leje qarkullimi, etj.
 - Të gjithë shpenzimet vjetore për taksat e qarkullimit, siguracionin e detyrueshëm TPL, kolaudimin, siguracionin Kasko, gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.
 - Të gjithë shpenzimet e nevojshme për mirëmbajtjen e automjeteve, si:
 - Ndërrim i vajit të motorrit, filtrave të tjerë (karburantit, vajit, ajrit, kondicionerit, etj.) sipas afatit të manualit të automjetit.
 - Ndërrim i vajit të kambios, sipas afatit të manualit të automjetit.
 - Ndërrimin e pjesëve të konsumit të automjeteve, në varësi të përdorimit të tyre, si ferrota, alkool frenash, alkool të sistemit të drejtimit, etj.
 - Ndërrimin e gomave sipas normativës së konsumit të ndërrimit pas përshkruarjes së kilometrave përkatëse.
 - Riparimin e automjeteve kur kjo është e nevojshme.

Marrja me qira e automjeteve kërkohet për një periudhë 48 (dyzet e tetë) muaj nga data e dorëzimit të automjeteve.

Kontroll i plotë mbi flotën

Institucioni duhet të ruajë të drejtën të ketë kontroll të plotë mbi flotën. Kompania operacionale ia mundëson teknikisht institucionit kontrollin mbi flotën e tij me anë të sistemeve GPS dhe sistemeve të menaxhimit të flotës.

Nëpërmjet sistemit GPS të inkorporuar, institucioni ka mundësinë të ketë kontroll të plotë mbi lëvizjen dhe mënyrën e përdorimit të makinave, sipas standarteve të industrisë.

Flota e makinave qëndron në punë 365 ditë të vitit 24/7.

Automjeti është një mjet pune që është ndërtuar për të lehtësuar punën e përdoruesit. Një defekt i automjetit nuk duhet të ndalojë aktivitetin për asnjë arsye. Marrja me qira operacionale (leasing)

e mjeteve ofron programin e zëvendësimit të menjëhershëm të mjetit me një tip tjetër, të ngjashëm ose të njëjtë deri sa defekti në automjet të jetë riparuar dhe mjeti të jetë gati për përdorim. Kontraktori duhet të marri masa për krijimin e rezervës së mjeteve për këto raste.

Marja me qera e mjeteve do të jetë për një periudhë 48 mujore, pra do të meren me zero km dhe do të jenë në përdorim të qeramarrësit për 48 muaj me një planifikim 12 mujor afërsisht 25 000 km. Kjo do të mundësojë efikasitet dhe ruajtje të imazhit të institucionit. Mbi këtë vlerësim Albpetrol sha ka planifikuar marrjen me qira operationale të një sasive mjetesh rrugore.

Gjithashtu Ofertuesi ka për detyrë:

- a. Menaxhimin e gjithë dokumentacionit të makinës përfshirë, lejen e qarkullimit, regjistrimin, nxjerrjen e targave, taksat vjetore dhe periodike, kontrollit teknik vjetor etj.*
- b. Menaxhimin e gjithë procesit të sigurimeve përfshirë: siguracionin TPL, kasko, dhe detyrimeve që rrjedhin në rast nevojash.*
- c. Menaxhimin e aksidenteve dhe situatave që vijnë si pasojë e aksidenteve përfshirë: asistencën e menjëhershme rrugore, njerëzore, tërheqjen e makinës deri në pikën më të afërt të riparimit.*
- d. Menaxhimin e ripërtëritjes së përvitshme të dokumentave shtetërore dhe teknike.*
- e. Kryerjen e riparimeve rutinë sipas skedave të prodhuesve.*
- f. Kryerjen e riparimeve jo-rutinë në rast nevoje.*
- g. Dhënie e makinës zëvendësuese (me të njëjtat parametra ose me të mira me specifikimet teknike në DST) brenda 48 oreve.*
- h. Asistenca teknike e ofruar dhe shërbimi i emergjences 24 ore*
- i. Menaxhim flote me anë të inkuorporimit të sistemit GPS.*

SHTOJCË

***Në Dokumentat Standarte të Tenderit me objekt:
“Marrje automjete me qira” me REF-85607-10-27-2023***

Autoriteti Kontraktor Albpetrol sha (Njësia e Prokurimit) bazuar në ligjin nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 75 “Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentat e tenderit”, dhe në zbatim të vendimit Nr. 1282/2023 të KPP-së për procedurën e prokurimit me objekt: “Marrje automjete me qira” me REF-85607-10-27-2023, vendosi të hartojë këtë shtojcë me përmbajtje si më poshtë:

- 1. Në Shtojcën 5 të DST-ve të këtij tenderi, “Formulari i Specifikimeve Teknike” bëhen ndryshimet si më poshtë:***

Ishte:

Automjet tipi 1 Pick Up (Dopio Kabine) sasia 14 (katërmbëdhjetë) copë të reja me zero kilometra

Specifikimet Teknike:

- Viti prodhimit/km *Min viti 2022 / 0 km*
- Cilindrata *Min 2200 cc.*
- Lenda djegese *Nafte.*
- Fuqia motorike *Min 110 Kë.*
- Numri i cilindrave *Min 4*
- Konsumi i kombinuar per 100 km *Max 8 litra /100km.*

Transmisioni:

- Kutia e shpejtesise(Kamio) *Manuale.*
- Terheqja *4x4.*

Permasat e autovetures:

- Gjatesia *Min 5 200 mm*
- Lartesia nga toka *Min 200 mm*
- Gjeresia *Min 1 800 mm*
- Lartesia *Min 1 700 mm*
- Distanca aksiale *Min 3 000 mm*

Gabina:

- Numri i dyerve *4*
- Numri i vendeve *Min 4+1*

Aksesore shtese:

- Me timon hidraulik ne krahun e majte.
- Frenat me sistem ABS.
- Sistem ASR, ESP
- Airbeg per shoferin dhe pasagjerin.
- Xhamat me komandim elektrik.
- Ajer i kondicionuar /Clima.
- Sistemi elektrik 12V, si dhe te jete konform normave te CE.
- Mbyllje e centralizuar e dyerve, komandim ne distance.
- Radio
- Pedanat anesore
- Tempomat
- Disqe alumini min 16

Ngjyra e negociueshme ne lidhjen e kontrates

Afati i dorëzimit duhet të jetë brenda 60 ditëve nga lidhja e kontratës.

Bëhet:

Automjet tipi 1 Pick Up (Dopio Kabine) sasia 14 (katërmbëdhjetë) copë të reja me zero kilometra

Specifikimet Teknike:

- Viti prodhimit/km *Min viti 2022 / 0 km*
- **Cilindrata** ***Max 2000 cc.***
- Lenda djegese *Nafte.*

- **Fuqia motorike** **Min 100 Kë.**
- *Numri i cilindrave* *Min 4*
- **Konsumi i kombinuar per 100 km** **Max 11 litra /100km.**

Transmisioni:

- *Kutia e shpejtesise(Kamio)* *Manuale.*
- *Terheqja* *4x4.*

Permasat e autovetures:

- *Gjatesia* *Min 5 200 mm*
- **Lartesia nga toka** **Min 180 mm**
- *Gjeresia* *Min 1 800 mm*
- *Lartesia* *Min 1 700 mm*
- *Distanca aksiale* *Min 3 000 mm*

Gabina:

- *Numri i dyerve* *4*
- *Numri i vendeve* *Min 4+1*

Aksesore shtese:

- *Me timon hidraulik ne krahun e majte.*
- *Frenat me sistem ABS.*
- *Sistem ASR, ESP*
- *Airbeg per shoferin dhe pasagjerin.*
- *Xhamat me komandim elektrik.*
- *Ajer i kondicionuar /Clima.*
- *Sistemi elektrik 12V, si dhe te jete konform normave te CE.*
- *Mbyllje e centralizuar e dyerve, komandim ne distance.*
- *Radio*
- *Pedanat anesore*
- *Tempomat*
- *Disqe alumini min 16*

Afati i dorëzimit duhet të jetë brenda 60 ditëve nga lidhja e kontratës.

2. Në Shtojcën 5 të DST-ve të këtij tenderi, “Formulari I Specifikimeve Teknike” bëhen ndryshimet si më poshtë:

Ishte:

Automjet tipi 2 SUV - Sasia 1 (nje) e re me zero kilometra

Specifikimet Teknike:

- *Viti prodhimit/km* *Min viti 2022 / 0 km*
- *Cilindrata* *Min 2200 cc.*
- *Lenda djegese* *Naftë.*
- *Fuqia motorike* *Min 140 kë.*
- *Numri i cilindrave* *Min 4*

- Konsumi i kombinuar per 100km Max 10 litra /100km.

Transmisioni:

- Kutia e shpejtesise(Kambio) Automatike
- Terheqja 4x4.

Permasat e autovetures:

- Gjatesia Min 4800 mm
- Lartesia nga toka Min 200 mm
- Gjeresia Min 1900 mm
- Lartesia Min 1800 mm
- Distanca aksiale Min 2800 mm

Gabina:

- Numri i dyerve 4
- Numri i vendeve Min 4+1

Aksesore shtese:

- Me timon hidraulik ne krahun e majte.
- Frenat me sistem ABS, ESP, ASR, EDB
- Airbag min 6 cope.
- Xhamat me nuance.
- Xhamat me komandim elektrik.
- Ajer i kondicionuar /Clima.
- Sistemi elektrik 12V, si dhe te jete konform normave te CE.
- Mbyllje e centralizuar e dyerve, komandim ne distance.
- Pasqyrat dhe xhamat elektrike
- Disqe Alumini min 18"
- Led para dhe mbrapa
- Timon Multifunksional
- Bluetooth , cruise control
- Xhamat e erret mbrapa
- Rregjistrim lartesisie per timonin
- Funksion start &stop
- Set riparim gome
- Sedilje lekure
- Kamera mbrapa

Afati i dorezimit duhet te jete brenda 60 diteve nga lidhja e kontrates

Bëhet:

Automjet tipi 2 SUV - Sasia 1 (nje) e re me zero kilometra

Specifikimet Teknike:

- Viti prodhimit/km Min viti 2022 / 0 km
- **Cilindrata** Min 2150 cc.
- Lenda djegese Nafte.
- Fuqia motorike Min 140 kë.
- Numri i cilindrave Min 4

- *Konsumi i kombinuar per 100km* *Max 10 litra /100km.*

Transmisioni:

- *Kutia e shpejtesise(Kambio)* *Automatike*
- *Terheqja* *4x4.*

Permasat e autovetures:

- *Gjatesia* *Min 4800 mm*
- *Lartesia nga toka* *Min 180 mm*
- *Gjeresia* *Min 1900 mm*
- *Lartesia* *Min 1690 mm*
- *Distanca aksiale* *Min 2800 mm*

Gabina:

- *Numri i dyerve* *5*
- *Numri i vendeve* *Min 4+1*

Aksesore shtese:

- *Me timon hidraulik ne krahun e majte.*
- *Frenat me sistem ABS, ESP, ASR, EDB*
- *Airbag min 6 cope.*
- *Xhamat me nuance.*
- *Xhamat me komandim elektrik.*
- *Ajer i kondicionuar /Clima.*
- *Sistemi elektrik 12V, si dhe te jete konform normave te CE.*
- *Mbyllje e centralizuar e dyerve, komandim ne distance.*
- *Pasqyrat dhe xhamat elektrike*
- *Disqe Alumini min 18”*
- *Led para dhe mbrapa*
- *Timon Multifunksional*
- *Bluetooth , cruise control*
- *Xhamat e erret mbrapa*
- *Rregjistrim lartesisie per timonin*
- *Funksion start &stop*
- *Set riparim gome*
- *Sedilje lekure*
- *Kamera mbrapa*

Afati i dorezimit duhet te jete brenda 60 diteve nga lidhja e kontrates

- Në Shtojcën 5 të DST-ve të këtij tenderi, “Formulari i Specifikimeve Teknike” bëhen ndryshimet si më poshtë:*

Ishte:

Automjet tipi 3 SUV - Sasia 1 (nje), e re me zero kilometra

Specifikimet Teknike:

- *Viti prodhimit/km* *Min viti 2022 / 0 km*
- *Cilindrata* *Min 1600 cc.*
- *Lenda djegese* *Nafte.*

- Fuqia motorike *Min 100 kë.*
- Numri i cilindrave *Min 4*
- Konsumi i kombinuar per 100km *Max 7 litra /100km.*

Transmisioni:

- Kutia e shpejtësisë (Kamio) *Automatike*
- Terheqja *2x4.*

Permasat e autovetures:

- Gjatesia *Min 4400 mm*
- Lartësia nga toka *Min 180 mm*
- Gjeresia *Min 1800 mm*
- Lartësia *Min 1600 mm*
- Distanca aksiale *Min 2600 mm*

Gabina:

- Numri i dymve *4*
- Numri i vendeve *Min 4+1*

Aksesore shtese:

- Me timon hidraulik ne krahun e majte.
- Frenat me sistem ABS, ESP, ASR,EDB
- Airbag min 6 cope.
- Xhamat me nuance.
- Xhamat me komandim elektrik.
- Ajer i kondicionuar /Clima.
- Sistemi elektrik 12V, si dhe te jete konform normave te CE.
- Mbyllje e centralizuar e dymve, komandim ne distance.
- Pasqyrat dhe xhamat elektrike
- Disqe Alumini min 18
- Led para dhe mbrapa
- Timon Multifunksional
- Bluetooth , cruise control
- Xhamat e erret mbrapa
- Rregjistrim lartësie per timonin
- Funksion start &stop
- Set riparim gome

Afati i dorezimit duhet te jete brenda 60 diteve nga lidhja e kontrates.

Bëhet:

Automjeti tipi 3 SUV - Sasia 1 (nje), e re me zero kilometra

Specifikimet Teknike:

- Viti prodhimit/km *Min viti 2022 / 0 km*
- **Cilindrata** *Min 1580 cc.*
- Lenda djegese *Naftë.*
- Fuqia motorike *Min 100 kë.*
- Numri i cilindrave *Min 4*

- Konsumi i kombinuar per 100km Max 7 litra /100km.

Transmisioni:

- Kutia e shpejtesise(Kamio) Automatike
- Terheqja 2x4.

Permasat e autovetures:

- Gjatesia Min 4400 mm
- Lartesia nga toka **Min 170 mm**
- Gjeresia Min 1800 mm
- Lartesia Min 1600 mm
- Distanca aksiale Min 2600 mm

Gabina:

- Numri i dyerve 5
- Numri i vendeve Min 4+1

Aksesore shtese:

- Me timon hidraulik ne krahun e majte.
- Frenat me sistem ABS, ESP, ASR,EDB
- Airbag min 6 cope.
- Xhamat me nuance.
- Xhamat me komandim elektrik.
- Ajer i kondicionuar /Clima.
- Sistemi elektrik 12V, si dhe te jete konform normave te CE.
- Mbyllje e centralizuar e dyerve, komandim ne distance.
- Pasqyrat dhe xhamat elektrike
- Disqe Alumini min 18
- Led para dhe mbrapa
- Timon Multifunksional
- Bluetooth , cruise control
- Xhamat e erret mbrapa
- Rregjistrim lartesisie per timonin
- Funksion start &stop
- Set riparim gome

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

- I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se, deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
- a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
 -
 - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
 -
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
- a) çmimet ;
 - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
 - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
 - d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

<i>Deklarata</i>
<p><i>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</i></p>
<p><i>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</i></p>

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 14.02.2024.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri